URDHËR
Nr. 6, datë 6.1.2023

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik"; dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. Endrit Musaj, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore, për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.
2. Kompetencat e deleguara të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në datën 31 dhjetor 2023.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet z. Endrit Musaj, drejtor i Drejtorisë së Inspektimit dhe Trajnimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido